



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr.214, Datë 11.10.2018

MBI

MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT MBI RREGULLAT E NDËRVEPRIMIT DHE SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 44 dhe nenit 55 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror“ dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe parashikimeve të Vendimit nr. 2018/02/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave,

Konstatoi se:

- Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, “ALBGAZ” sh.a. ka përshtatur draft-rregulloren dhe Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, duke e paraqitur për shqyrtim dhe miratim në ERE me shkresën Nr. 101 Prot, datë 08.08.2018;
- Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 01.07.2006 dhe si e tillë duhet të mbajë në konsideratë:
 - ✓ Parashikimet e Rregullores së (BE) nr. 715/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
 - ✓ Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2015/703, të datës 30 prill 2015;
 - ✓ Vendimin nr. 2018/02/PHLG.EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, me të cilin është miratuar Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave
- Gjithashtu gjatë përshtatjes së Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. janë mbajtur në konsideratë:
 - ✓ Parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”;
 - ✓ Licencimi i shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të Gazit Natyror;

- ✓ Licencimi i shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e Shpërndarjes së Gazit Natyror;
- ✓ Certifikimi Përfundimtar i Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror “ALBGAZ” sh.a.;
- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit European të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij.
- Me Vendimin nr. 197, datë 03.09.2018, Bordi i ERE-s ka filluar procedurat për miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “ALBGAZ” sh.a..
- Me shkresën e ERE-s Nr. 55/57 Prot. është bërë njoftimi në median e shkruar në datat 05.09.2018 dhe 06.09.2018 dhe janë ftuar palët e interesuara për të paraqitur objeksionet në lidhje me sa më sipër. Në përfundim të afatit 15 ditor nuk ka objeksione nga palë të interesuara.
- Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin nr. 550, datë 04.10.2018 “Për dhënien e rekomandimeve për Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror “ALBAGAZ” sh.a.”, i rekomandon ERE-s transpozimin e dokumentit sipërcituar, pa ndryshime, si dhe kërkon informim në lidhje me zbatimin e rekomandimit brenda 90 ditëve. Ky rekomandim përputhet me vendimarrjen e Bordit të ERE-s për fillimin e procedurave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI